Worcester Public Schools
Worcester, Massachusetts

Departamenti i Menaxhimit
të Objekteve

115 NE Cutoff
Worcester, Massachusetts 01606

Tel. (508) 799-3151
Faks (508) 799-3144
tranki@worcesterschools.net

Kristen Tran
Koordinatore e Shëndetit dhe Sigurisë
Mjedisore

29 Gusht, 2022

Të dashur Staf, Prindër, Kujdestarë/e dhe Nxënës/e të Worcester Public Schools:

Në përputhje me Aktin 40 CFR 763, për Masat ndaj Rrezikut të Asbestit (Asbestos Hazard Response Act-AHERA), të Agjencinë së U.S. për Mbrojtjen e Mjedisit (Environmental Protection Agency-EPA), në vjeshtën e vitit 1989, Worcester Public Schools filluan inspektimet e secilës prej ndërtesave tona për material ndërtimi që përmban asbest (ACBM). Gjetjet e inspektimit dhe planet e menaxhimit të asbestit janë në dosje, në zyrën administrative të secilës shkollë.

EPA kërkon që ri-inspektimet e të gjithë ACBM të kryhen çdo 3 vjet. Inspektorë/e të Akredituar/a për kontrollin e Asbestit i kryen këto rishikime në Tetor të vitit 2019. Një Planifikues i Akredituar i Menaxhimit të Asbestit rishikoi rezultatet e ri-inspektimeve dhe rekomandoi veprimet që Worcester Public Schools duhet të vazhdojnë të zbatojnë, në mënyrë që të menaxhojmë siç duhet ACBM në ndërtesat tona. Raundi i ardhshëm i ri-inspektimeve do të realizohet gjatë periudhës së vjeshtës. Një mbikëqyrje periodike e të gjithë ACBM kryhet gjithashtu nga një Inspektor/e i/e akredituar i/e Asbestit çdo gjashtë muaj.

Përveç raporteve origjinale të inspektimit të AHERA-s, raportet më të fundit 3-vjeçare të ri-inspektimit dhe mbikëqyrjes gjashtëmujore janë në dosjen e planit të menaxhimit, në zyrën administrative të secilës shkollë. Gjithkush është i/e mirëpritur të shohë planin e menaxhimit të asbestit në çdo kohë, gjatë orëve normale të shkollës (nga e hëna në të premte).

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me procedurat e përdorura për të menaxhuar siç duhet asbestin në ndërtesat tona, lutemi të kontaktoni Personi i Përcaktuar për AHERA, të Worcester Public Schools, Kristen Tran, në (508) 799-3151 ose në tranki@worcesterschools.net.

Sinqerisht,

Kristen Tran

Kristen Tran
Worcester Public Schools
Personi i Përcaktuar për AHERA

Worcester Public Schools është një Institucion Punësimi/Edukimi, që ofron Mundësi të Barabarta/Veprime Afirmuese dhe nuk diskriminon, pavarësisht racës, ngjyrës, prejardhjes, seksit, gjinisë, moshës, besimit fetar, origjinës kombëtare, identitetit ose shprehjes gjinor, gjendjes civile, orientimit seksual, paaftësisë, shtatzënisë ose një gjendjeje që ka lidhje me të, statusit të veteranit apo të qenit i/e pastrehë. Worcester Public Schools mundësojnë qasje të barabartë në punësim, si edhe një gamë të plotë të programeve të edukimit të përgjithshëm dhe profesional. Për më shumë informacion lidhur me Mundësitë e Barabarta/Veprimet Afirmuese lidhuni me Menaxherin/en e Burimeve Njerëzore, 20 Irving Street, Worcester, MA 01609, 508-799-3020.